

Matja e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në Shqipëri, 2022

Tiranë, më 29 Shkurt 2024: INSTAT publikon rezultatet e vitit 2022 të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) e cila mat nivelin e jetesës, varfërinë relative dhe privimin material dhe social në familjet shqiptare (Shih Metodologjia).

Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në Shqipëri, në vitin 2022 është 20,6 %, duke pësuar një rënie prej 1,4 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021.

Treguesit e varfërisë në anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, bazohen në konceptin relativ të varfërisë, i cili merr në konsideratë të ardhurat familjare të disponueshme, numrin e pjesëtarëve në familje (madhësinë e familjes) dhe shpërndarjen e të ardhurave ndërmjet grupeve të popullsisë.

Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për një person në vitin 2022 është vlerësuar me 225.931 lekë, në krahasim me 191.791 Lekë që ishte në vitin 2021.

Në vitin 2022 janë vlerësuar rreth 576.316 individë që jetojnë nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër, kundrejt rreth 622.705 individë të vlerësuar në vitin 2021. Numri i individëve në rrezik për të qenë të varfër është ulur me rreth 7,4 %.

Duke filluar nga viti 2021, treguesi i privimit material, intensiteti i ulët në punësim dhe **rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social** (AROPE) është modifikuar nga ana metodologjike duke u bazuar në objektivin e ri të Bashkimit Europian “Europa 2030” (Shih Metodologjia).

Sipas objektivit të vendosur nga Bashkimi Europian për mbrojtjen e të drejtave sociale të përfshirë në agjendën “Europa 2030”, popullsia që është në rrezik për të qenë e varfër ose në përjashtim social (AROPE) duhet të reduktohet me të paktën 15 milion deri në vitin 2030 dhe prej tyre të paktën 5 milion duhet të jenë fëmijë.

Ky është treguesi kryesor për monitorimin e objektivit të Europa 2030 për varfërinë dhe përjashtimin social dhe ishte treguesi kryesor për monitorimin e varfërisë në Strategjinë Europa 2020.

Shkalla e thelluar e privimit material sipas strategjisë Europa 2020 tregon përqindjen e individëve që jetojnë në familje të cilët nuk përballojnë të paktën 4 nga 9 kategoritë e privimit material.

Ky tregues është vlerësuar 33,2 % në vitin 2022, kundrejt 35,2% vlerësuar në vitin 2021, duke shënuar rënie prej 2 pikë përqindje.

Privimi material dhe social i referohet treguesve që tregojnë kushtet materiale që ndikojnë në cilësinë e jetës së familjeve dhe individëve.

Shkalla e thelluar e privimit material dhe social sipas agjendës Europa 2030, paraqet përqindjen e popullsisë që nuk përballojnë të paktën 7 nga 13 kategori të privimit material dhe social. Për vitin 2022, ky tregues është vlerësuar 37,0 % kundrejt 39,0% vlerësuar në vitin 2021.

Intensiteti në punësim i familjes i referohet numrit të muajve që të gjithë individët e familjes kanë punuar kundrejt numrit gjithsej të muajve që teorikisht duhet të punojnë gjatë vitit (12 muaj).

Familjet të cilat konsiderohen me intensitet shumë të ulët në punësim përcaktohen në kufirin 20 %.

Sipas strategjisë EU 2020, Individët e grupmoshës 18-59 vjeç, të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim në vitin 2022 sipas vlerësimeve përbëjnë 11,3 %, kundrejt 12,4 % rezultuar në vitin 2021, duke pasqyruar një rënie prej 1.1 pikë përqindje.

Sipas agjendës EU 2030 individët e grupmoshës 18-64 vjeç, të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim në vitin 2022 sipas vlerësimeve përbëjnë 10,4 %, kundrejt 11,7 % rezultuar në vitin 2021, duke pasqyruar një rënie prej 1.3 pikë përqindje.

Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE) i referohet individëve që janë në rrezik për të qenë të varfër, ose thellësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale, ose që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim. Në vitin 2022, ky tregues sipas strategjisë Europa 2020 është vlerësuar 41,6 %, kundrejt 43,9 % vlerësuar në vitin 2021 ndërsa sipas agjendës Europa 2030, ky tregues është vlerësuar 44,5 %, kundrejt 46,6 % vlerësuar në vitin 2021.

Përfitimet sociale, si pensionet e pleqërisë dhe ato familjare, të përfshirë në të ardhurat familjare të disponueshme, ndikojnë në uljen e rrezikut për të qenë i varfër. Nëse në nivelin e të ardhurave nuk do të përfshiheshin të gjitha llojet e përfitimeve sociale, rreziku për të qenë i varfër në vitin 2022 është vlerësuar 36,5 % kundrejt 24,5 % që është vlerësuar nëse do të përfshiheshin në nivelin e të ardhurave përfitimet sociale vetëm nga pensionet e pleqërisë dhe ato familjare.

Tab. 1 Treguesit kryesorë të rrezikut për të qenë i varfër dhe përjashtimit social, 2019, 2020, 2021, 2022

| Treguesit | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---------|---------|---------|---------|
| Rreziku për të qenë i varfër (%) | 23,0 | 21,8 | 22,0 | 20,6 |
| Individët thellësisht të privuar materialisht (%) (mungesa e 4 nga 9 kategoritë e privimit material) | 37,1 | 34,7 | 35,2 | 33,2 |
| Individët thellësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale (%) (mungesa e 7 nga 13 kategoritë e privimit material) | 42,5 | 38,8 | 39,0 | 37,0 |
| Intensitetet shumë të ulët në punësim (18-59 vjeç) (%) | 12,4 | 11,6 | 12,4 | 11,3 |
| Intensitetet shumë të ulët në punësim (18-64 vjeç) (%) | 12,0 | 11,1 | 11,7 | 10,4 |
| Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROE-Europa 2020) (%) | 46,2 | 43,4 | 43,9 | 41,6 |
| Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROE-Europa 2030) (%) | 50,7 | 46,1 | 46,6 | 44,5 |
| Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër; familje me një person (Lekë) | 170.785 | 186.242 | 191.791 | 225.931 |
| Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër; familje me dy të rritur dhe me dy fëmijë në varësi: (Lekë) | 358.65 | 391.108 | 402.76 | 474.455 |
| Rreziku për të qenë i varfër para përfitimeve sociale (%) (Pensionet e pleqërisë dhe ato familjare të përfshira në përfitimet sociale) | 38,1 | 37,9 | 39,0 | 36,5 |
| Rreziku për të qenë i varfër pas përfitimeve sociale (Pensionet e pleqërisë dhe ato familjare të përjashtuara nga përfitimet sociale) (%) | 26,1 | 24,8 | 25,2 | 24,5 |

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019, 2020, 2021, 2022

Rreziku për të qenë i varfër sipas grupmoshave dhe gjinisë është analizuar për tre grupmosha.

Trendi në zbritje vihet re në të tre grupmoshat, por një zbritje më të madhe kanë grupmoshat 18-64 vjeç ku rreziku për të qenë i varfër në vitin 2022, në krahasim me vitin 2021, është zvogëluar me 1.6 pikë përqindje në këtë grupmoshë. Grupmosha 65 vjeç e lart ka pësuar një rënie të lehtë në vitin 2022 me 0.1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021.

Tab. 2 Rreziku për të qenë i varfër sipas grupmoshave dhe gjinisë (në%)

| Grupmosha | 2019 | | | 2020 | | | 2021 | | | 2022 | | |
|------------|---------|-------|----------|---------|-------|----------|---------|-------|----------|---------|-------|----------|
| | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| 0-17 vjeç | 27,9 | 31,7 | 29,7 | 26,7 | 30,1 | 28,4 | 26,8 | 30,2 | 28,5 | 26,3 | 28,6 | 27,4 |
| 18-64 vjeç | 22,3 | 23,3 | 22,8 | 21,4 | 21,7 | 21,6 | 21,7 | 22,0 | 21,8 | 19,8 | 20,5 | 20,2 |
| 65+ | 12,9 | 14,8 | 13,9 | 13,0 | 14,5 | 13,8 | 13,1 | 14,8 | 14,0 | 13,0 | 14,7 | 13,9 |
| Gjithsej | 22,2 | 23,8 | 23,0 | 21,4 | 22,3 | 21,8 | 21,5 | 22,5 | 22,0 | 20,1 | 21,1 | 20,6 |

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019, 2020, 2021, 2022


Rreziku për të qenë i varfër sipas statusit të punësimimit, për të punësuarit e moshës 18 vjeç e lart, në vitin 2022 ka shënuar rënie me 2.1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021. Rreziku për të qenë i varfër tek individët e papunë ka pësuar një rritje prej 0.4 pikë përqindje ndërsa tek pensionistët ka pësuar një rritje prej 0.2 pikë përqindje.

Tab.3 Rreziku për të qenë i varfër sipas statusit të punësimit (në %)

| Individët 18 vjeçe lart | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|-------------------------|------|------|------|------|
| Të punësuar | 14,6 | 12,7 | 12,6 | 10,5 |
| Jo në punësim | 26,4 | 25,9 | 26,4 | 25,8 |
| Të papunë | 39,2 | 37,8 | 38,9 | 39,3 |
| Pensionistë | 14,0 | 13,9 | 14,0 | 14,2 |
| Inaktivë – Tjetër | 28,7 | 28,9 | 29,8 | 28,3 |

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019, 2020, 2021, 2022

Përqindja e individëve në rrezik për të qenë të varfër sipas tipit të familjes, në vitin 2022, në familjet pa fëmijë në varësi, vlerësohet të jetë më e ulët krahasuar me familjet me fëmijë në varësi, përkatësisht 12,2% dhe 24,4 % e individëve. Familje me fëmijë në varësi konsiderohen ato familje që kanë fëmijë të moshës nën 18 vjeç si dhe persona të moshës 18 deri 24 vjeç që jetojnë të paktën me një prind dhe janë ekonomikisht inaktiv. Një vit më parë këto përqindje ishin përkatësisht 12,8 % dhe 25,9 % .

Fig. 1 Rreziku për të qenë i varfër sipas tipit të familjes (në %)

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019, 2020, 2021, 2022

Niveli i pabarazisë sipas shpërndarjes së të ardhurave matet nëpërmjet koeficientit Gini dhe raportit të kuintileve të të ardhurave (S80/S20).

Koeficienti Gini mat pabarazinë në shpërndarjen e të ardhurave, ku vlera 0 % shpreh barazinë e plotë dhe të gjithë individët kanë të ardhura të njëjta, ndërsa një koeficient Gini i barabartë me 100 % shpreh pabarazinë e plotë ku vetëm një person ka të gjitha të ardhurat.

Në vitin 2022, Gini është vlerësuar 31,0 %, duke pësuar rënie me 2 pikë përqindje nga viti 2021.

Raporti kuintileve S80/S20, është një indikator i cili mat pabarazinë në të ardhura me anë të raportit të nivelit më të lartë të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara (kuintili i fundit) me nivelin më të ulët të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara (kuintili i parë). Ai paraqet raportin ndërmjet të ardhurave gjithsej të ekuivalentuara të 20 % të popullsisë me të ardhura më të larta dhe të 20 % të popullsisë me të ardhura më të ulëta. Në vitin 2022 raporti S80/S20 është vlerësuar 5,2 kundrejt raportit 5,7 që u vlerësua në vitin 2021. Për popullsinë 65 vjeç e lart ky raport në vitin 2022 është vlerësuar me 3,6 kundrejt 3,9 që ishte në vitin 2021. Për personat nën 65 vjeç ky raport u vlerësua 5,4 në vitin 2022 kundrejt raportit 6,1 që ishte në vitin 2021.

Tab.4 Treguesit e pabarazisë

| Treguesit e pabarazisë | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|------------------------|------|------|------|------|
| GINI (në %) | 34,3 | 33,2 | 33,0 | 31,0 |
| Raporti S80/S20 | 6,4 | 5,9 | 5,7 | 5,2 |
| S80/20 Moshë 65 e lart | 4,1 | 4,0 | 3,9 | 3,6 |
| S80/20 Moshë nën 65 | 6,8 | 6,2 | 6,1 | 5,4 |

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019, 2020, 2021, 2022

Rritja apo ulja e kufirit të rrezikut për të qenë i varfër ndikon në nivelin e rrezikut për të qenë i varfër (shih Tab.5). Përqindja e individëve në rrezik për të qenë të varfër, në rastet kur kufiri i rrezikut për të qenë i varfër përcaktohet në 50 % të medianës së të ardhurave të ekuivalentuara për frymë është vlerësuar 13,9 % në vitin 2022, krahasuar me 15,0 % të vlerësuar në vitin 2021.

Tab.5 Shpërndarja rreth kufirit të rrezikut për të qenë i varfër (në %)

| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|--|------|------|------|------|
| Nën 40% e medianës së të ardhurave të Ekuivalentuara | 9,7 | 8,5 | 8,5 | 7,4 |
| Nën 50% e medianës së të ardhurave të Ekuivalentuara | 16,2 | 14,4 | 15,0 | 13,9 |
| Nën 70% e medianës së të ardhurave të Ekuivalentuara | 29,4 | 28,2 | 28,5 | 27,6 |

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019, 2020, 2021, 2022

Në vitin 2022, të ardhurat mesatare mujore të disponueshme për frymë/të ekuivalentuara kanë pësuar një rritje me 15,4 %, krahasuar me vitin 2021.

Tab.6 Të ardhurat mesatare mujore të disponueshme të individëve


| | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|--------|--------|--------|--------|
| Të ardhurat mesatare mujore për frymë/ të ekuivalentuara (Lekë) | 27.849 | 30.169 | 30.962 | 35.725 |

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019, 2020, 2021, 2022

Krahasimi me shtetet e tjera

Krahasimi i rrezikut për të qenë i varfër për vitin 2022, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Rajonit dhe të Bashkimit Evropian tregojnë se: Vlera më e lartë e varfërisë relative shënohet në Bullgari (22,9%), Estonia (22,8%), Letonia (22,5%), Rumania (21,2%), Lituania (20,9%), ndjekur nga Shqipëria (20,6%). Vlerat më të ulëta të varfërisë regjistrohen në Republikën Çeke (10,2%), Sllovenia (12,1%), Hungaria (12,1%), Norvegjia (12,2%) dhe Danimarka (12,4%). Mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian (27 shtete) është 16,5 %. (Shih Fig. 2).

Fig. 2 Rreziku për të qenë i varfër sipas shteteve, 2022 (në %)



Burimi: Eurostat 2022

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

Metodologjia

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) u realizua për herë të parë në vendin tonë në vitin 2017 ku referencë janë të ardhurat e vitit 2016. Publikimi i vitit 2022 ka referencë të ardhurat e vitit 2021. Rezultatet paraqesin statistika të krahasueshme me vendet e tjera, si dhe sigurojnë të dhëna të besueshme në fushën e varfërisë relative, përjashtimit social dhe të ardhurave familjare, duke ndihmuar në këtë mënyrë në hartimin e politikave anti-varfëri. Deri në vitin 2012, i vetmi burim i matjes së nivelit të jetesës, varfërisë absolute dhe mirëqënies së familjeve shqiptare ka qenë Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës e njohur si AMNJ. Kjo anketë ka mbledhur një sërë treguesish monetarë dhe jo monetarë duke sjellë një larmi informacioni për përdorues të ndryshëm. Nëpërmjet AMNJ është synuar matja e varfërisë bazuar në shpenzimet e konsumit duke përdorur kufirin absolut të varfërisë ndërsa AANJ bazohet në të ardhurat e familjes duke përdorur kufirin relativ të varfërisë.

Nisur nga këto ndryshime metodologjike të përdorura në këto dy anketa pritet që edhe informacioni i Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) të jetë i ndryshëm, krahasuar me të dhënat e ofruara nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ).

Mbulimi: Anketa AANJ mbulon të gjitha familjet (Njësitë Ekonomike Familjare) e territorit të Republikës së Shqipërisë pavarësisht nga madhësia e tyre ose karakteristikat socio-ekonomike.

Përjashtohen nga studimi: Individët që jetojnë në banesa kolektive të të gjitha llojeve (Konviktet, shtëpitë e të moshuarve, spitalet, burgjet, qendrat e rehabilitimit, kampet etj.).

Koncepti Familje ka të bëjë me Njësinë Ekonomike Familjare (NjEF) e cila i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët jetojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Madhësia e kampionit të arritur: Anketa AANJ në vitin 2022 përfshin një kampion bruto prej 9.103 Familje (NjEF) ku të përgjigjur janë 7.382 Familje (NjEF), në vitin 2021 kampioni ishte 9.136 Familje (NjEF) nga të cilat të përgjigjur ishin 7.692 Familje (NjEF).

Periudha e referencës: Është e ndryshme në varësi të informacionit të mbledhur, për:

- **Të ardhurat:** është viti i fundit kalendarik - N - 1 (për anketën AANJ 2022 është viti 2021, AANJ 2021 është viti 2020 dhe për anketën AANJ 2019 është viti 2018).
- **Privimin material:** është momenti kur realizohet intervista - (Viti 2022, 2021, 2020, 2019).

Sipas metodologjisë për matjen e varfërisë, kufiri i rrezikut për të qenë i varfër llogaritet në bazë të konceptit relativ (i varfër në raport me të tjerët) dhe përcaktohet në 60 % të medianës së të ardhurave familjare disponibël të ekuivalentuara duke përdorur shkallën e ekuivalentuar të modifikuar të OECD. Të ardhurat gjithsej të disponueshme të familjes (NjEF) konsiderohen të ardhurat gjithsej neto (të ardhurat pas taksave dhe sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore) të marra nga të gjithë anëtarët e familjes (NjEF).

Të ardhurat e ekuivalentuara:

Të ardhurat disponibël të ekuivalentuara për individë janë konsideruar të ardhurat gjithsej disponibël të familjes pasi janë ndarë sipas shkallës së modifikuar të OECD. Në shpërndarjen për person secili anëtar i familjes (NjEF) zotëron të njëjtat të ardhura që korrespondojnë me të ardhurat ekuivalente të disponueshme të familjes (NjEF). Kjo do të thotë që secili anëtar i familjes gëzon të njëjtin nivel jetese. Rrjedhimisht, në shpërndarjen e të ardhurave për person, të ardhurat që i atribuohen çdo personi nuk përfaqësojnë pagën, por një tregues të nivelit të jetesës.

Shkalla e ekuivalentimit:

Madhësia ekuivalente i referohet shkallës së modifikuar të OECD-së e cila jep peshën 1,0 personit të parë të rritur të familjes (mbi 14 vjeç), 0,5 personave të tjerë të moshës 14 vjeç e lart që jetojnë në familje dhe 0,3 për secilin fëmijë nën moshën 14 vjeç. Shembull: Të ardhurat e familjes me dy të rritur dhe dy fëmijë nën 14 vjeç janë ndarë me një peshë prej $1 + 0,5 + (2 \cdot 0,3) = 2,1$, të ardhurat e familjes me 2 të rritur ndahen me peshë $1 + 0,5 = 1,5$, etj.

Treguesit e varfërisë dhe përjashtimit social bazohen në konceptin e varfërisë relative, të cilët marrin në konsideratë të ardhurat e disponueshme të familjeve, numrin e anëtarëve të familjes dhe shpërndarjen e të ardhurave të popullsisë gjithsej.

Përkufizimet e treguesve kryesorë:

Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër përfaqëson të ardhurat më të ulta vjetore të disponueshme që një person të mos konsiderohet i varfër. Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër është përcaktuar në 60 % të medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara për të gjitha familjet.

Niveli i Rrezikut për të qenë i varfër tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara janë nën kufirin e rrezikut për të qenë i varfër.

Privimi Material, tregon nivelin e jetesës së popullsisë nga shkalla e privimit material. **Personat thellësisht të privuar materialisht (Europa 2020)** janë ata që jetojnë në familje që nuk mund të përballojnë financiarisht të paktën katër nga nëntë kategoritë e privimit material të lidhura me asetet, kushtet e banimit apo aspektet financiare.

Më poshtë paraqiten kategoritë e privimit material sipas strategjisë Europa 2020 që përcaktojnë treguesin e privimit material:

1. Vonesat në pagesat e kredisë ose të qerasë për banesën kryesore, shpenzimet për shërbimet bazë, blerjet me këste ose pagesa të tjera të kredive të marra;
2. Pamundësia për të përballuar shpenzimet për pushimet vjetore një javë larg nga shtëpia;
3. Pamundësia për të përballuar një vakt me mish, pule, peshk (ose ekuivalentin për vegjetarianët) një herë në dy ditë;
4. Pamundësia për të përballuar një shpenzim të paparashikuar financiar me vlerën 30.000 lekë të reja;
5. Pamundësia financiare për të përballuar një telefon (duke përfshirë telefonin celular);
6. Pamundësia financiare për të pasur një TV me ngjyra;
7. Pamundësia financiare për të pasur një makinë larëse;
8. Pamundësia financiare për të patur një makinë për përdorim personal;
9. Pamundësia financiare e familjes për mbajtjen e shtëpisë ngrohtë në mënyrë të përshtatshme.

Shkalla e thelluar e privimit material dhe social (Europa 2030) paraqet përqindjen e personave që jetojnë në familje që nuk mund të përballojnë të paktën shtatë nga trembëdhjetë kategoritë e privimit (6 kategori që lidhen me privimin në nivel individ dhe 7 kategori që lidhen me privimin në nivel familje).

Lista e kategorive në nivel familje:

1. Vonesat në pagesat e kredisë ose të qerasë për banesën kryesore, shpenzimet për shërbimet bazë, blerjet me këste ose pagesa të tjera të kredive të marra;
2. Pamundësia për të përballuar shpenzimet për pushimet vjetore një javë larg nga shtëpia;
3. Pamundësia për të përballuar një shpenzim të paparashikuar financiar me vlerën 30.000 lekë të reja;
4. Pamundësia për të përballuar një vakt me mish, pule, peshk (ose ekuivalentin për vegjetarianët) një herë në dy ditë;
5. Pamundësia financiare e familjes për mbajtjen e shtëpisë ngrohtë në mënyrë të përshtatshme;
6. Pamundësia financiare për të patur një makinë për përdorim personal;
7. Zëvendësimi i mobiljeve të vjetra me të reja.

Lista e kategorive në nivel individ:

1. Mundësia për të pasur lidhje interneti;
2. Zëvendësimi i rrobave të vjetra me disa rroba të reja;
3. Të kesh dy palë këpucë që përshtaten siç duhet (përfshirë një palë këpucë për të gjitha stinët);
4. Shpenzimi i një sasive të vogël parash çdo javë për veten e tij/saj;

5. Mundësia për të patur aktivitete të rregullta në kohën e lirë;
6. Takime me miqtë/familjen për një pije/ vakt të paktën një herë në muaj.

Intensiteti i punësimit në familje është raporti i numrit gjithsej të muajve që pjesëtarët në moshë pune të familjes kanë punuar gjatë periudhës së referencës së mbledhjes së të ardhurave, dhe numrit gjithsej të muajve që të njëjtët pjestarë të familjes teorikisht mund të punonin në të njëjtën periudhë (12 muaj).

Një person në moshë pune është konsideruar një person i grupmoshës 18-59 vjeç sipas Europa 2020 dhe i grupmoshës 18-64 vjeç sipas objektivave Europa 2030, duke përjashtur personat që i përkasin grupmoshës 18-24 vjeç që janë në varësi të familjes dhe ekonomikisht jo aktivë si dhe me përjashtim të personave që marrin pension familjar dhe personave joaktivë të moshës 60–64 vjeç që jetojnë në familjet në të cilat burimi kryesor i të ardhurave është pensioni.

Intensiteti në punësim është: shumë i ulët (0-20%), i ulët (20%-45%), mesatar (45%-55%), i lartë (55%-85%) dhe shumë i lartë (85%-100%).

Intensiteti shumë i ulët në punësim i referohet situatës së personave në familje ku asnjë nuk punon, ose punon shumë pak, që do të thotë se anëtarët e familjes në moshë pune punojnë vetëm 20 % apo më pak se numri gjithsej i muajve që ata mund të punonin gjatë periudhës së referencës.

Rreziku për të qënë i varfër ose përjashtimi social është përqindja e individëve që janë në rrezik për të qënë të varfër ose thellësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale ose me intensitet shumë të ulët në punësim.

Tabela e mëposhtme tregon ndryshimet midis **Rrezikut për të qënë i varfër ose përjashtimi social (AROE)** të përcaktuar për strategjinë Europa 2020 dhe për objektivat Europa 2030.

| Treguesi | Europa 2030 | Europa 2020 |
|---|--|--|
| Shkalla e thelluar e privimit material | Shkalla e thelluar e privimit material dhe social (SMSD): Përqindja e popullsisë që nuk përballojnë të paktën 7 deri në 13 kategori të privimit (6 lidhur me individin dhe 7 lidhur me familjen). | Shkalla e thelluar e privimit material (SMD): Përqindja e popullsisë që nuk mund të përballojë të paktën 4 nga 9 kategoritë e privimit material të konsideruar nga shumica e njerëzve si të dëshirueshëm apo edhe të nevojshëm për të patur një jetesë të përshtatshme. |

Matja e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në Shqipëri, 2022

| | | |
|--|---|--|
| <p>Rreziku për qenë të varfër</p> | <p>Përqindja e personave në totalin e popullsisë që janë në rrezik për qenë të varfër.</p> | <p>Përqindja e personave në totalin e popullsisë që janë në rrezik për qenë të varfër.</p> |
| <p>Treguesi i intensitetit të ulët në punësim</p> | <p>Personat nga 0-64 vjeç që jetojnë në familje ku të rriturit (grupmosha 18-64, duke përfshirë studentët e moshës 18-24 vjeç dhe personat ekonomikisht jo aktivë si dhe personat e grupmoshës 60-64 vjeç që janë joaktivë dhe që jetojnë në një familje ku të ardhurat kryesore janë pensionet) punojnë vetëm 20 % apo më pak se numri gjithsej i muajve që ata mund të punonin gjatë periudhës së referencës.</p> | <p>Personat nga 0-59 vjeç që jetojnë në familje ku të rriturit (ata të moshës 18-59 vjeç, duke përfshirë studentët e moshës 18-24 vjeç) punojnë vetëm 20 % apo më pak se numri gjithsej i muajve që ata mund të punonin gjatë periudhës së referencës.</p> |